



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 759 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2020

VENDIM  
Nr. 225, datë 21.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.07.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim «**Foinike-Butrint, 2020**» drejtuar nga Prof.Dr Shpresa Gjongecaj dhe Prof.Asoc. Belisa Muka (IA) në bashkëpunim me Prof.Asoc. Guiseppe Lepore dhe Prof.Asoc. Enrico Giorgi (Universiteti i Bolonias-Itali), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga IA në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:  
Në **Foinike**, Dokumentimi i kërkimeve arkeologjike në dy sektorët që u punua edhe gjatë vitit 2019: a) Në terracën në jug të agorasë helenistike; b) Sektori lindor;  
Në **Butrint** : a) Vijimi i rilevimit të mureve rrethuese. Puna do të për qendrohet veçanërisht në traktin e murit që kalon mbi Sanktuarin e Asklepit; b) dokumentime
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brënda vitit 2020;
3. Në rastet kur parashikohen ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre, dhe të shoqërohen me projekt konsolidimi/konservimi/restaurimi pranë IKTK;
4. Të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së lista e inventarit të gjetjeve me qëllim grumbullimin, informimin/ regjistrimin sipas rastit dhe ekspozimin e tyre në Muze;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

